



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:153686

Datë: 04.04.2024

Numri i dokumentit: 05545986

PA1.nr.1847/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mehmet Ndrecaj - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Abdullah Ahmeti, anëtarë, me pjesëmarrjen e praktikantes gjyqësore Gentijana Manaj-Gashi si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit I.TH nga fshati, Komuna e Kamenicës dhe personit juridik K.N.SH.P P & A.C sh.p.k., me seli në fshatin Komuna e Lipjanit për shkak të veprës penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.7 në lidhje me par.2 të Kodit Penal të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së përbashkët të akuzuarit I.TH dhe përfaqësuesit të personit juridik KNPSH P & A.C SH.P.K, av. H.L të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm P.nr.433/2021 të datës 04.11.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 05.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e përbashkët e të akuzuarit I.TH dhe përfaqësuesit të personit juridik K.N.P.SH P & A.C Sh.P.K, av. H.L, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan P.nr.433/2021 të datës 04.11.2022, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjilan, me aktgjykimin, P.nr.433/2021 të datës 04.11.2022, të akuzuarin I.TH dhe personin juridik K.N.P.SH P & A.C SH.P.K i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Shkaktim i rrezikut të përgjithshëm nga neni 356 par.7 në lidhje me par.2 të Kodit Penal të Kosovës dhe i ka shqiptuar të akuzuarit I.TH dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë. Me pëlqimin e të pandehurit I.TH dënimi i shqiptuar me burg prej 6 (gjashtë) muaj, në pajtim me nenin 47 të KPRK-së, i zëvendësohet në dënim me gjobë, në shumë prej 800 (tetëqind) Euro. Të

akuzuarit Personit juridik K.N.P.SH P & A.C SH.P.K i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 2,000 (dy mijë) euro të cilin dënim do ta paguaj në afat prej 90 ditësh pasi që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë. Të akuzuarit obligohen që të paguajnë taksën për kompensimin e viktimave të kimit dhe atë në shumë prej 30 (tridhjetë) euro si dhe të paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 30 (tridhjetë) euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Pala e dëmtuar, R.XH për realizimin e kërkesës pasurore është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë të përbashkët kanë paraqitur:

I akuzuari I.TH dhe përfaqësuesit të personit juridik K.N.P.SH P & A.C SH.P.K, av. H.L për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovojë në tërësi si të bazuar ankesën e përbashkët të të pandehurve I.TH dhe K.N.P.SH P & A.C SH.P.K dhe aktgjykimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje, apo të njëjtin ta ndryshoj në kuptim të lirimit nga akuza të të pandehurve.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.1882/22 të datës 16.12.2022, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e përbashkët e të akuzuarit I.TH dhe përfaqësuesit të personit juridik K.N.P.SH P & A.C SH.P.K, av. H.L, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit caktoi dhe mbajti seancën e kolegjit, konform dispozitës së nenit 390 të KPP-së në të cilën prezantoi i akuzuari I.TH dhe përfaqësuesi ligjor i personit juridik K.N.SH.P P & A.C sh.p.k, av. H.L. Prokuroria e Apelit, si dhe i dëmtuari, ndonëse të njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt nuk prezantuan në seancë. Përfaqësuesi ligjor i personit juridik K.N.SH.P P & A.C sh.p.k, av. H.L deklaroi se qëndron në tërësi pranë ankesës së paraqitur brenda afatit ligjore dhe propozimit si në ankesë. Tutje shton se, gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur që t'a vërtetoi drejtë dhe ligjshëm gjendjen faktike në këtë çështje penale, dhe kjo si rrjedhojë e çmuarjes dhe vlerësimit të gabuar të provave të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësor. Nga këto prova nuk u provua se të pandehurit e kanë kryer veprën penale të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm , sepse me kohë dhe në përputhje me dispozitat ligjore, gjatë tërë kohëzgjatjes së punimeve, i kanë zbatuar me përpikëri masat mbrojtëse dhe paralajmëruese për evitimin e rrezikut nga aksidentet eventuale në vend punishten lëndore. Po ashtu shton se është për t'u çuditur fakti se gjykata fare nuk e çmoi kontributin e të dëmtuarit në shkaktimin e aksidentit në të cilin ka pësuar lëndime të lehta trupore, përderisa aksidenti ishte shkaktuar ekskluzivisht nga pakujdesia e tij dhe atë duke qenë polic i trafikut rrugorë, e që pikërisht i dëmtuari sipas detyrës zyrtare e ka për detyrë t'i mbikqyrë edhe rregullsinë teknike të rrugës nëpër të cilën qarkullojnë automjetet dhe qarkullojnë automjetet dhe qytetarët gjatë ekzekutimit të punimeve në rrugë. Tutje deklaron se punimet në këtë vend punishte kanë zgjatur mbi dy vite, dhe ka qenë fakt botërisht i njohur për të gjithë qytetarët se janë duke u zhvilluar punimet ndërtimore dhe se duhet shtuar kujdesin nga makineritë ndërtimore dhe nga mekanizmi tjetër prezent, Megjithatë, mbi dy vite sa kanë zgjatur punimet askush, pos të dëmtuarit R.XH nuk ka pësuar ndonjë aksident, falë shtimit të masave të sigurisë në vend punishte nga ana e kryesit të punimeve. I mbrojturi i

tij në cilësinë e menaxherit të këtij vend punimi, pos përcjelljes së punimeve detyrë e tij ka qenë edhe sinjalizimi adekuat, vendosja e shenjave të trafikut dhe shenjave paralajmëruese për parandalimin e fatkeqësive që mund të pësojnë qytetarët, meqenëse punime janë zhvilluar në qendër të qytetit të Gjilanit dhe kanë zgjatur një kohë të gjatë dhe atë nga viti 2019 e deri në vitin 2021, ndërsa ka qenë detyrim ligjorë dhe praktik e përhershme e punë kryesit që në fillim dhe në mbarim të rrugës ku janë kryer punimet të vendosen dhe janë vendosur shenjat e trafikut me paralajmërimin “ Kujdes punimet në rrugë”. Po ashtu në kohën kur i dëmtuari ka pësuar aksident, punimet kanë qenë në përfundim e sipër, ujëmbledhësat / pusetat kanë qenë të betonuara me kapakë metalik të mbuluar sipër, që do të thotë se pusetat në momentin e aksidentit kanë qenë të mbuluara, dhe nuk ka pas nevojë të vendosen shiritat paralajmërues në to, meqenëse thellësia standarde e tyre ka qenë 4-5cm dhe mbi to ka mund të kalohet lirisht. I akuzuari I.TH deklaron se mbështet fjalët e avokatit dhe mbetet në tërësi pranë ankesës dhe propozimit si në ankesë.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

-Ankesa nuk është e bazuar.

I akuzuari Izet Thaqi dhe përfaqësuesi i personit juridik K.N.P.SH P & A.C SH.P.K, av. H.L e ankimojnë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të të drejtës materiale, me pretendimet se pikëpamjet juridike dhe përfundimi i gjykatës së shkallës së parë nuk mund të pranohen nga të pandehurit si të rregullta dhe të ligjshme, sepse në aktgjykimin e ankimuar nuk jepen arsye të mjaftueshme lidhur me faktet dhe provat të cilat e provojnë përgjegjësinë penale të të pandehurve dhe në arsyetimin e tij nuk specifikohen provat konkrete materiale, në bazë të të cilave gjyqtari i çështjes ka krijuar bindje se të akuzuarit me veprimet e tyre inkriminuese ditën kritike kanë shkaktuar rrezik të përgjithshëm, andaj këto të meta të hasura në aktgjykimin e ankimuar paraqesin dilema përkitazi me ekzistimin e veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të të pandehurve në këtë çështje penale, andaj mbi këtë bazë me pa mëdyshje, rezulton se gjykata nuk e ka shqyrtuar në themel çështjen, kur në mungesë të provave fajësuese të të pandehurve, ka përfunduar se të njëjtit duhet shpallë fajtor dhe duhet dënuar si në dispozitiv . Të pandehurit gjatë gjithë procedimit të çështjes, me fakte të provuara janë mbrojtur se nuk janë kryes të veprës penale e cila u është vënë në barrë gjatë ekzekutimit të punimeve ndërtimore në vend punishten “” në Gjilan, i kanë zbatuar paraprakisht të gjitha masat e sigurisë në rrugë të parapara me Ligjin për Ndërtimin dhe me Ligjin për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit. I pandehuri në cilësinë e personit përgjegjës në personin juridik, gjatë gjitha fazave të shqyrtimit gjyqësor i ka konsideruar në tërësi si të pabaza pretendimet e organit të ndjekjes, se kinse si rrjedhojë e lëshimeve në punishte përkatësisht si pasojë e mosndërmarrjes së masave paralajmëruese dhe mbrojtëse në vend punishte , ka pësuar dhe është lënduar i dëmtuari R.XH. I pandehuri duke qenë në cilësinë e menaxherit të këtij vend ndërtimi, pos përcjelljes së punimeve detyrë e tij ka qenë edhe sinjalizimi adekuat, vendosja e shenjave të trafikut dhe shenjave paralajmëruese për parandalimin e fatkeqësive që mund të pësojnë qytetarët, meqenëse punime janë zhvilluar në

qendër të qytetit të Gjilanit dhe kanë zgjatur një kohë të gjatë dhe atë nga viti 2019 e deri në vitin 2021, ndërsa ka qenë detyrim ligjor dhe praktikë e përhershme e punë kryesit që në fillim dhe mbarim të rrugës ku janë kryer punimet të vendosen dhe janë vendosur shenjat e trafikut me paralajmërimin “ Kujdes punimet në rrugë”. I njëjti ka deklaruar se në kohën kur i dëmtuari ka pësuar aksident, punimet kanë qenë në përfundim e sipër, ujëmbledhësat/pusetat/ kanë qenë të betonuara me kapak metalik të mbuluar sipër, që do të thotë se pusetat në momentin e aksidentit kanë qenë të mbuluara, dhe nuk kanë pas nevojë që të vendosen shiritat paralajmërues në to, meqenëse thellësia standarde e tyre ka qenë 4-5cm dhe mbi to ka mund të kalohet lirshëm. Faktin se në vendin e aksidentit ujëmbledhësi nuk ka qenë i hapur por i mbyllur dhe me thellësi sipas standardeve teknike për depërtimin e ujit në të njëjtin, i pandehuri I.TH e ka argumentuar përmes fotografive nga vendngjarja të cilat gjendjen n shkresat e lëndës, ndërsa sipas tij, shkak i aksidentit në të cilin ka pësuar i dëmtuari, ka qenë rrjedhojë e pakujdesisë ekstreme të të dëmtuarit dhe shpejtësia e madhe e ngarjes së biçikletës nga i njëjti sepse koha kur ka ndodh aksidenti ka qenë muaji gusht, ditë me diell dhe me dukshmëri të madhe, me gjithë formën dhe dimensionet e rregullta të ujëmbledhësit, megjithatë afër saj ka ekzistuar edhe shenja e trafikut, por me sa duket dikush e ka larguar apo e ka marr për skrap. Punimet në këtë vend punishte kanë zgjatur mbi dy vite dhe ka qenë fakt botërisht i njohur për të gjithë qytetarët se janë duke u zhvilluar punimet ndërtimore dhe se duhet shtuar kujdesin nga makineritë ndërtimore dhe nga mekanizmi tjetër prezent, Megjithatë, mbi dy vite sa kanë zgjatur punimet askush, pos të dëmtuarit R.XH nuk ka pësuar ndonjë aksident, falë shtimit të masave të sigurisë në vend punishte nga ana e kryesit të punimeve. Është për t'u çuditur fakti se gjykata fare nuk e çmoi kontributin e të dëmtuarit në shkaktimin e aksidentit në të cilin ka pësuar lëndime të lehta trupore, përderisa aksidenti ishte shkaktuar ekskluzivisht nga pakujdesia e tij dhe atë duke qenë polic i trafikut rrugorë, e që pikërisht i dëmtuari sipas detyrës zyrtare e ka për detyrë t'i mbikëqyrë edhe rregullsinë teknike të rrugës nëpër të cilën qarkullojnë automjetet dhe qarkullojnë automjetet dhe qytetarët gjatë ekzekutimit të punimeve në rrugë. Andaj, konsideron se gjykata ka gabuar kur me aktgjykimin e ankimuar ia falë besimin deklaratës së të dëmtuarit, deklaratës së dëshmitarit B.P dhe provave të tjera të shtjelluara dhe vendimin e saj e mbështet ekskluzivisht mbi dëshminë e tyre pa ndonjë arsytim të veçantë e injoron mbrojtjen e të pandehurve. Gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur që t'a vërtetoi drejtë dhe ligjshëm gjendjen faktike në këtë çështje penale, dhe kjo si rrjedhojë e çmuarjes dhe vlerësimit të gabuar të provave të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësor. Nga këto prova nuk u provua se të pandehurit e kanë kryer veprën penale të shkaktimin të rrezikut të përgjithshëm , sepse me kohë dhe në përputhje me dispozitat ligjore, gjatë tërë kohëzgjatjes së punimeve, i kanë zbatuar me përpikëri masat mbrojtëse dhe paralajmëruese për evitimin e rrezikut nga aksidentet eventuale në vend punishten lëndore.

Edhe pse nuk është parashtruar ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke u bazuar në nenin 394, paragrafi 1. të KPP, sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit edhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat kjo gjykatë i shiqon çdo herë sipas detyrës zyrtare, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e tij. Aktgjykimi i ankimuar është konkret dhe i qartë, në arsytimin e aktgjykimit të

kundërshtuar gjykata e shkallës së parë ka përshkruar gjendjen faktike të cilën e ka vërtetuar. Gjykata e shkallës së parë provat i ka vlerësuar në pajtim me dispozitat e KPPK-së, duke paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsye i merr si të provuara ose të pa provuara. Në arsyetimin e aktgjykimit përkitazi me ngjarjen e kryerjes së veprës penale në fjalë, janë dhënë arsye të duhura mbi të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje juridike penale, të cilat si të drejta i aprovon edhe kjo gjykatë dhe nuk e sheh të nevojshme të bëjë edhe njëherë vlerësimin për këtë.

Sa i përket gjendjes faktike, sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet ankimore nuk janë të bazuara, kjo për faktin se gjendja faktike në këtë çështje penale është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ngase sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, me provat e administruara gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit të kenë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vendosur kur të akuzuarit i ka shpallur fajtor për veprat penale me të cilat janë akuzuar, sepse nga të gjitha provat e administruara dhe vlerësuara, sikurse janë provat personale dhe materiale dhe atë dëshmisë së të dëmtuarit R.XH, dëshmitarit B.P, provave materiale si raporti i incidentit, Njësia Rajonale trafikut në Gjilan nr. 2020-CR-373 i datës 22.08.2020, raporti i oficerit të RSJ në Gjilan i datës 28.08.2020, fotodokumentacioni nga vendi i ngjarjes, vërtetimi mjekësor i Spitalit të Përgjithshëm në Gjilan nr. 18588 i datës 22.08.2020, ekspertiza e ekspertit mjekësor Dr. S.M Ref. Nr. 05/11-20 e datës 16.11.2020. lista e spitalit me numër të =historisë 09-346/334 e datës 26.08.2020, Raporti i Spitalit të përgjithshëm Gjilan me nr. të protokollit 25676 i datës 25.09.2020, fletë shëndetësore nr. 882, raporti i Spitalit të Përgjithshëm Gjilan nr. 861 të datës 26.06.2020, raporti i Spitalit të Përgjithshëm Gjilan nr. 1805 të datës 26.10.2020, raporti i klinikës specialistike të ortopedisë Koci-207 i datës 26.10.2020, katër CD si dhe shkresat tjera të lëndës, pra të gjitha provave së bashku si dhe secilës prej tyre veç e veç, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike. Pra kolegji vlerësoi se gjendja faktike në këtë çështje penale është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ngase me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor si ato personale ashtu edhe ato materiale është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se të akuzuarit ti kenë kryer veprat penale për të cilat janë akuzuar. Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, konkludimet e gjykatës së shkallës së parë në lidhje me faktet vendimtare i konsideron të drejta dhe të ligjshme pasi që në tërësi është provuar që të akuzuarit janë kryerës të veprave penale për të cilat janë akuzuar dhe shpallur fajtorë, andaj kolegji i gjykatës së apelit andaj i vlerëson si të drejta dhe të ligjshme përfundimet e gjykatës së shkallës së parë, përkitazi me faktet vendimtare në këtë çështje penale.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit meqë gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë drejtë është aplikuar edhe ligji penale kur gjykata të akuzuarit i ka shpallur fajtor për veprat penale e cila u vihet në barrë me aktin akuzues dhe i ka shqiptuar dënimin si në aktgjykimin e ankimuar. Ngase në veprimet e të akuzuarve konsumohen të gjitha elementet e veprave penale e cila i vihet në barrë, në rastin konkret nuk ka rrethana të cilat përjashtojnë kundërligjshmërinë e apo përgjegjësinë penale të akuzuarve. Në rastin konkret është aplikuar ligji penal që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, drejtë janë aplikuar dispozitat për caktimin e llojit dhe matjes së lartësisë së dënimit dhe se drejtë i ka

vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese me rastin e përcaktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit

Edhe pse nuk është parashtruar ankesë sa i përket vendimit mbi dënimin Gjykata e Apelit duke vepruar sipas detyrës zyrtare e në pajtim me dispozitat e nenin 396 të KPPRK-së dhe konstatoi se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ku gjatë matjes së shqiptimit të dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, duke u bazuar në nenet 73,74 dhe 75 të KPRK-së, ka marrë për bazë rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit në këtë aspekt si rrethana lehtësuese për të akuzuarit ka marrë për bazë, se i është përgjegjgur menjëherë ftesës së policit –dëshmitarit duke dalur në vendin e ngjarjes për ta parë gjendjen faktike, faktin se përgjatë dy viteve të punimeve në rrugë nga kjo kompani nuk kishte ndodhur asnjëherë më parë që dikush të lëndohet në rrugë nga rrjedha e punimeve , gjë që tregon se të njëjtit më parë kishin qenë të kujdesshëm gjatë kryerjes së punimeve dhe vendosjes së shenjave sinjalizuese , gjithashtu si rrethanë lehtësuese ka marrë edhe sjelljen e mirë të tij në gjykatë, ndërsa si rrethanë rënduese ka marrë për bazë përgjegjësinë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të kësaj vepre penale si dhe lëndimin e lehtë trupor të dëmtuarit. Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, dhe gjen se të gjitha këto rrethana, japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.1847/22, më datë 05.03.2024

Procesmbajtësja,
Gentijana Manaj-Gashi

Anëtarët e kolegjit:
Skender Çoçaj

Kryetar i kolegjit,
Mehmet Ndrecaj

Abdullah Ahmeti